



Directorate for  
Personal Data  
Protection

Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
të Republikës së Maqedonisë



National Agency for  
Protection of  
Personal Data

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave  
Personale

## DEKLARATË MBI BASHKËPUNIMIN E MËTEJSHËM Ndërmjet

DREJTORISË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, REPUBLIKA E MAQEDONISË  
DHE

AGJENCISE SHETETRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, REPUBLIKA E  
KOSOVËS

Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Maqedonisë dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dëshirojnë të bëjnë deklaratë të përbashkët duke afirmuar bashkëpunimin e tanishëm dhe gatishmërinë e tyre për të vazhduar bashkëpunimin reciprok.

Ky bashkëpunim është për të përmirësuar shkëmbimin e përvojave më të mira praktike dhe njohurive midis ekspertëve të të dy Institucioneve në lidhje me fushat në vijim:

- Zhvillimin Legjislativ
- Bashkëpunimin me akterë ndërkombëtarë, me qëllim të arritjes së një zgjidhjeje të harmonizuar të problemeve të ndryshme
- Shkëmbimin e përvojës në fushën e zhvillimeve të reja teknologjike
- Projektet e themeluara nga Bashkimi Evropian
- Transferimi i të dhënave personale

Të dy Institucionet janë të vetëdijshme për nevojën e pashmangshme për të rritur bashkëpunimin midis autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave, me qëllim të krijimit të një aplikimi të qëndrueshëm të legjislationit të mbrojtjes së të dhënave ekzistues në vende të ndryshme.

Institucionet e poshtëshënuara në frymën e mirë të kësaj Deklarate, në përputhje me gatishmërinë e tyre do të bëjnë vizita të ndërsjella në fushën e shkëmbimit të përvojave dhe zgjerimit të bashkëpunimit.

Është mendim i të dy autoriteteve që kjo do rezultojë në bashkëpunim më të mirë, dhe shkëmbim të informacioneve ndërmjet tyre dhe përfundimisht, në mbrojtje më të madhe të të dhënave të qytetarëve.

*për Drejtorinë për Mbrojtjen  
e të Dhënave Personale të Republikës  
së Maqedonisë*

*për Agjencionin Shtetërore  
për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
të Kosovës*

Dimitar Gjeorgjievski  
Drejtore

Ruzhdi Jashari  
Mbikqyresi Kryesor Shtetërore